

KUSHTE TË PËRGJITHSHME TË CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË KONTRATËS

Kjo kontratë midis palëve:

Shoqëria e Sigurimeve INTERSIG – Vienna Insurance Group sha, person juridik i regjistruar me Vendimin e Gjykatës nr 26103 dt.18.07.2001, K.Fiskal K12201002T me adresë: Rr. "Ismail Qemali", Samos Tower/ kati II, ish Bllok, P.O.Box 8292, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Gentian SULA**, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, që këtu më poshtë do të quhet INTERSIG;

dhe

Shoqëria e përcaktuar në garancinë bashkangjitur që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar, që këtu më poshtë do të quhet "Debitori Kryesor".

Objekti i Kontratës - Sigurimi i detyrimit që mund të lind në të ardhmen nga konfiskimi i Garancisë që INTERSIG ka lëshuar apo do të lëshojë për "Debitorin Kryesor" dhe në favor të personave të tretë, siç dhe përcaktohet në këtë kontratë.

Baza Ligjore - Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

Vlefshmëria

1. Fillon datën e lidhjes së kontratës mes palëve kontraktuese dhe përfundon me mbarimin e saj.
2. Kontrata zgjat deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së Formularit (Çertifikatës) së Garancisë ose në rast zbatimi nga INTERSIG të detyrimit përcaktuar në Garanci, deri në shlyerjen e plotë të të gjitha detyrimeve që lindin për "Debitorin Kryesor", siç dhe janë përcaktuar në këtë Kontratë.
3. Zgjidhet në mënyrë të menjëhershme dhe pa kundërshtime ("ipso jure") kur "Debitori Kryesor", me mbarimin e kontratës së lidhur midis "Përfituesit" dhe Kontraktuesit (Debitorit Kryesor).
4. Në se afati i mbarimit të Kontratës do të shtyhet nga palët, Formulari i Garancisë do të mbetet në fuqi, kundrejt paraqitjes së një deklarate me shkrim nga ana e Kontraktuesit (Debitorit Kryesor) dhe lëshimit të një dokumenti shtesë, ose dublikatë nga INTERSIG.

Palët sa më sipër bien dakort si vijon:

Neni 1 – Qëllimi i Kontratës

1. INTERSIG ka lëshuar për "Debitorin Kryesor" një (Formular) Çertifikatë Garancie sipas të dhënave në garancinë bashkëngjitur, në mbulim të përgjegjësisë së "Debitorit Kryesor" ndaj "Përfituesit të Garancisë".
2. INTERSIG detyrohet kundrejt "Përfituesit" të paguajë shumën për të cilën bëhet garant, në rast se "Debitori Kryesor" (Kontraktuesi) nuk respekton titullin e kontratës për zbatimin e saj, në mënyrë të tillë, që të përbëjë shkak ligjor, për ekzekutimin e kushtit penal të vendosur.
3. INTERSIG do të paguajë shumën e garantuar brenda afatit të 30 (tridhjetë) ditëve nga mbërritja e kërkesës së arsyetuar me shkrim nga "Përfituesi", vetëm kur bëhen të zbatueshme kushtet e ekzekutimit të Garancisë së Kontratës.

Neni 2 - "Debitori Kryesor" pranon përmbajtjen e Formularit (Çertifikatës)/ve të Garancisë dhe detyrohet të paguajë primin përkatës të sigurimit si dhe të përdorë Formularin (çertifikatën) e Garancisë për qëllimin e mirë për të cilin ai/ata lëshohet duke ju përmbajtur moralisht dhe ligjërisht të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga përdorimi i tij/tyre.

Neni 3 - INTERSIG ka të drejtën e rimbursimit nga "Debitori Kryesor" dhe/ose Dorëzanësi të çdo shume brenda vlerës së garantuar mësipër (neni 1) plus interesa, kamatvonesa apo çdo shpenzim për rimbursimin e çdo shume që ai bëhet përgjegjës të paguajë në përputhje me detyrimet e parashikuara në Formularin (çertifikatën) e Garancisë. Nëse "Debitori Kryesor" i ndodhur në faj, brenda afatit 10 ditor, nuk i paguan INTERSIG shumën e garantuar, "Debitori Kryesor" pranon detyrimin për të paguar për çdo ditë vonesë kamatën në masën 2% të shumës së garantuar, ose të pjesës së papaguar.

Neni 4 - Në rast se Përfituesi paraqet kërkesë për konfiskim Garancie, "Debitori Kryesor" brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës do t'i paguajë INTERSIG, ose do të vendos si CASH kolateral në emër të tij çdo shume që INTERSIG bëhet përgjegjës të paguajë sipas përcaktimit në pikën 3 mësipër pavarësisht nëse INTERSIG ka kryer apo jo pagesë sipas detyrimeve të parashikuara në Formularin (Çertifikatën) e Garancisë.

Neni 5 - Dorëzanësi detyrohet t'i përgjigjet INTERSIG me kërkesën e parë me shkrim, pavarësisht nga aftësia paguese e "Debitorit Kryesor", për çdo shumë që sipas Formularit (Çertifikatës) së Garancisë, INTERSIG bëhet përgjegjës të paguajë.

Neni 6 - Duke paguar shumën apo çdo shumë brenda kufirit të shumës së përcaktuar në këtë Kontratë, INTERSIG do t'i kalojnë të drejtat e Përfituesit lidhur me shumën e garantuar sipas Formularit (Çertifikatës) së Garancisë, duke përfshirë këtu çdo mjet siguri dhe aksesorë të tjerë që sigurojnë pagimin e kësaj shume. Asnjë autoritet ose person nuk do të ndërmarrë ndonjë veprim për të paragjykuar këtë.

Neni 7 - Të gjithë detyrimet e çfarëdo natyre që INTERSIG duhet të përballojë për kthimin e shumës së garancisë së paguar janë në ngarkim të "Debitorit Kryesor".

Neni 8 - Pjesë integrale e kësaj Kontrate është Formulari (Çertifikata) e Garancisë objekt i kësaj Kontrate.

Neni 9 - Shtesa ose ndryshime të kësaj Kontrate bëhen me shkrim.

Neni 10 - Për çfarë nuk është përcaktuar shprehimisht në këtë Kontratë do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Pjesa IV, mbi Detyrimet dhe Pjesa V Dorëzania.

Neni 11 - Në rast se ndonjë apo më shumë nga dispozitat e kësaj Kontrate dhe akteve të tjera të cilave kjo Kontratë i referohet, shpallen apo mund të konsiderohen të pavlefshme, të paligjshme apo të pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria apo zbatueshmëria e dispozitave që mbeten nuk do të ndikohet. Palët në mirëbesim do të negociojnë për të zëvendësuar dispozitat e kontestueshme me dispozita të vlefshme me efekte riparuese të përafërta me qëllimin e palëve të shprehur sipas kësaj Kontrate.

Neni 12 - Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve si rezultat i kësaj Kontrate zgjidhen me mirëkuptim, në rast të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 13 - Kjo Kontratë lidhet sipas datës të përcaktuar në garanci, u përpilua me vullnetin e lirë të palëve dhe firmoset pa vërejtje nga palët.

SIGURUESI:
INTERSIG – VIG SHA

I SIGURUARI :
